



Mblidhet i plotë Këshilli i AMA-s

Ditën e mërkurë, më datë 9 dhjetor, 2015 u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në këtë mbledhje ishin prezentë të gjithë anëtarët e Këshillit të AMA-s. Mungesa e dy anëtarëve të Këshillit, ka krijuar pengesa në vendimmarrjen e AMA-s, për shkak të mosplotësimit të kuorumit të nevojshëm të përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Në mbledhjen e Këshillit të AMA-s, morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Z.Gentian Sala	Kryetar
Z.Sami Nezaj	Zëvendëskryetar
Z.Gledis Gjipali	Anëtar
Z.Piro Misha	Anëtar
Zj.Suela Musta	Anëtar
Z.Zylyftar Bregu	Anëtar

AMA ra dakord që vendimi “Mbi aplikimin e shoqërive “Top Channel” sh.a., “ Tv Klan” sh.a, “Digitalb” sh.a dhe “Super Sport” sh.a., për marrje licence private kombëtare transmetimi audioviziv numerik sipas procedurës Beauty Contest”, do të merret në mbledhjen e radhës së Këshillit, pasi të gjithë anëtarët të njihen me dosjet e aplikimit të subjekteve.

Këshilli i AMA-s, në përputhje me rendin e ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Emërimin e z.Erald Kapri anëtar i Këshillit të Ankesave.
2. Mospërzgjedhjen e z.Genc Çausi për pozicionin Kryetar të Këshillit të Ankesave.
3. Mospërzgjedhjen e z.Erion Tase për pozicionin Kryetar të Këshillit të Ankesave.
4. Mospërzgjedhjen e zj.Alida Cenaj për pozicionin Anëtar të Këshillit të Ankesave.
5. Mospërzgjedhjen e zj.Aurela Dyrmishi për pozicionin Anëtar të Këshillit të Ankesave.
6. Mospërzgjedhjen e z.Genc Çausi për pozicionin Anëtar të Këshillit të Ankesave.
7. Miratimin e projektbuxhetit të AMA-s për vitin 2016.
8. Miratimin e Kodit Etik të punonjësve të administratës së Autoritetit të Mediave Audiovizive.
9. Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Albtelecom”sh.a., për subjektin OSHMA “Albtelecom” për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV).
10. Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Albtelecom” sh.a., për subjektin OSHMA “Albtelecom” për përsëritjen online të shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

11. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Tring TV” sh.a. për subjektin OSHMA “Tring TV” për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV).
12. Dhënien e autorizimit shoqërisë Tibo sh.p.k., për subjektin OSHMA « Tibo », për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT).
13. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Bleta” sh.p.k., për subjektin OSHMA “Bleta” për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV).
14. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Ultranet” sh.p.k., për subjektin OSHMA për “Ultranet” përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT).
15. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Abissnet” sh.a., për subjektin OSHMA “Abissnet” për përsëritjen online të shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT).
16. Rrëzimin e kërkesës së subjektit person fizik Altin Sharka, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Hysgjokaj”, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit.
17. Mosdhënien e autorizimit, shoqërisë “Zero Gravitet” sh.p.k., për përsëritjen të shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV).
18. Rinovimin e autorizimit dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit subjektit person fizik Emin Grenica, për ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Pojan”.
19. Mosdhënien e autorizimit, shoqërisë sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet “STV” dhe “STV Folk”.
20. Konstatimin e pavlefshmërisë të autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Ardit Metohu, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Arban”.
21. Konstatimin e pavlefshmërisë të autorizimit lëshuar për subjektin person fizik z.Albert Bisha, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Berti Cable”.
22. Konstatimin e pavlefshmërisë të autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Shpëtim Bego, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Dushk”
23. Miratimin e kërkesës së shoqërisë Extra Channel sh.p.k., për ndryshimin e emërtimit (logos) së televizionit privat vendor nga “Mad TV Albania” në “IN TV”.
24. Miratimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Tv Blu” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “Tv Blu” dhe ndreqjen e gabimit material të pikës 3 të vendimit nr. 06, datë 26.03.2014 si më poshtë:
“Për subjektin televiziv privat kabllor “Tv Blu”, afati i vlefshmërisë së autorizimit fillon nga data 04.04.2013, me kohëzgjatje 5 (pesë) vjet.”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Këshilli gjithashtu mori në shqyrtim ankimet administrative ndaj sanksioneve më gjobë të vendosura ndaj subjekteve audiovizivë, duke vendosur:

1. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionin me gjobë nr. 35, datë 16.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “Vlora Cable” sh.p.k., për subjektin kabllor “TV Vlora Cable”.
2. Lënien në fuqi të sanksionit me gjobë nr. 15/1, datë 22.09.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj personit fizik Dritan Memushi, autorizuar për subjektin kabllor “TV Tepelena Sat”.
3. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 41, datë 07.10.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndaj personit fizik Bilbil Hajdini, për subjektin kabllor “TV Fieri”.
4. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 32, datë 08.09.2015 të vendosur ndaj shoqërisë “ABC Neës” sh.a., për televizion “TV ABC Neës”, në masën 1.000.000 (një milion) lekë.
5. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 43, datë 02.11.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndaj shoqërisë “TV KL-ED Kabëll” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “TV KL-ED”.
6. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionin me gjobë nr. 45, datë 06.11.2015 të vendosur ndaj shoqërisë “Tele. Co. Albania” sh.p.k., për subjektin kabllor “TV Tele. Co. Albania”, në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

Tiranë, 9 Dhjetor 2015

Autoriteti i Mediave Audiovizive